

## **AKT THEMELIMI**

Sot ne dt. 22/04/2023 me cilesine e "Ortakeve Themelues",  
**LEONARD MAJKO** i datelindjes 27-07-1966, i lindur ne SARANDE, SHQIPERI, madhor  
me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me  
Nr.ID G60727082K ,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 13/12/2021,  
i cili me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur  
ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date  
14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKB", ne Kodin  
Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me perjegjesi të kufizuar, me  
emertimin "**MONNA TOURS**" shpk.

### KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

#### Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**MONNA TOURS**" shpk. Shoqeria  
do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne  
baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku  
themelues.

#### Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria "**MONNA TOURS**" shpk, eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri  
me perjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te  
Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për  
detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqeria "**MONNA TOURS**" shpk, eshte një e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota  
dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës  
së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

#### Neni 3

Selia

#### Shoqeria e ka seline ne adresen:

**Sarande, Lagjja nr.1, Rruga Skenderbeu, godina me Nr.Pasurie 13/83-N4, Zona  
Kadastrale 8641.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale,  
si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese  
se Ortakut te vetem.

#### Neni 4

Objekti i veprimtarise

**Operator turistik, sherbime turistike ne det dhe ne toke. Shitetje me  
Varke Turistike te pushuesve. Guida te ndryshme turistike. Motorra dhe  
makina me qera.**

#### Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per një periudhe kohore te papercaktuar, duke  
filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

## KREU II

### KAPITALI

#### Neni 6

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 10,000 leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues:**LEONARD MAJKO**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë te pergjithshme 10,000 Leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise.

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar **10,000 Leke**.

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar **10,000 Leke**, do te paguhet ne avance nga ne ortaket. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaket per gjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

#### Neni 7

##### Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

## KREU II

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

##### Organ Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

#### Neni 9

##### Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga dy administrator te perbashket.

Administratoret e shoqerise jane **z. LEONARD MAJKO** i datelindjes 27-07-1966, i lindur ne SARANDE, SHQIPERI, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID G60727082K ,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 13/12/2021 **Z.ARDIAN MARTIKO** e datelindjes 09-02-1971, i lindur ne SARANDE , SHQIPERI, madhere me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID H10209100T ,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 08/01/2021

Administratoret emerohen me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, te cilet kane te gjitha kompetencat per te kryer bashkarisht te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim te Asamblese se ortakeve te

shoqerise.

Neni 10  
Kompetencat

Administratoret kane kompetencat si me poshte:

Administratori **LEONARD MAJKO** i cili eshte ortaku i vetem i shoqerise ka te gjitha kompetencat e plota dhe te pakufizuara qe te veproje i vetem,i pavarur ne perputhje me statutin dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" per te gjitha veprimet e nevojshme lidhur me aktivitetin ekonomik te shoqerise.

**Z.ARDIAN MARTIKO do te veproj si Administrator i shoqerise dhe do te kete vetem te drejten qe te kryej : Veprimtarine Turistike te Shoqerise, destinacionet, oraret , caktimin e cmimeve, dokumentimin e aktivitetit ekonomik te ardhur nga ky aktivitet, ne keto pergjegjesi nuk perfshihen pergjegjesit tekniko ligjore te mjetit lundrues dhe sigurimit ne udhetim te mjetit dhe pasagjereve.**

Administratoret angazhojne shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjafqueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratoreve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratoret ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japid pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11  
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilin eshte kriuar sic mund të jene

a.Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

b.Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c.Kur plotesoher afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 13  
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te pote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemclare me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italiane dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen

nga Ortaku i vetem themelues i shoqerise tregtare "**MONNA TOURS**" shpk, nenshkruehet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

**ORTAKU I VETEM**

**LEONARD MAJKO**

**ADMINISTRATORET**

**LEONARD MAJKO**

**ARDIAN MARTIKO**